



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 696 Prot.

Tiranë, më datë 01.07.2020

VENDIM

Nr. 181, datë 09.06.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim “**Vezhgime përnjohëse kodrinore në zonën veri-perendimore (Lezhë-Shkodër), 2020**” drejtuar nga Dr. Rovena Kurti, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga IA në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Ekspedita e këtij viti synon plotësimin e hartës së shtrirjes së këtyre nekropoleve, kryesisht në zonën kodrinore që kufizon në lindje fushën e Mbishkodrës, midis lumit Kir dhe kodrave të Kastratit;
 - Vazhdimi i serveit në zonën e Nënshkodrës, me qëllim dokumentimin e ekstremit verior të kurrizit kodrinor të Rrencit, në fshatin Mal Kolaj.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brënda vitit 2020;
3. Në rastet kur parashikohen ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre, dhe të shoqërohen me projekt konsolidimi/konservimi/restaurimi pranë IKTK;
4. Të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së lista e inventarit të gjetjeve me qëllim grumbullimin, informimin/ regjistrimin sipas rastit dhe ekspozimin e tyre në Muze;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

